

INFOSTAT



REVISTË INFORMATIVE
INSTAT

EDITORËT

DREJTOR BOTIMI

Dr. Elsa Dhuli, Instituti i Statistikave

BORDI EDITORIAL

1. Helda Curma, Instituti i Statistikave
2. Altin Xhikneli, Instituti i Statistikave
3. Alma Kondi, Instituti i Statistikave
4. Majlinda Nesturi, Instituti i Statistikave
5. Ermir Liço, Instituti i Statistikave
6. Erjola Gjika, Instituti i Statistikave
7. Ilirjana Kraja, Instituti i Statistikave

KOORDINATOR:

Enkelejt Avdyli, Instituti i Statistikave

Copyright INSTAT 2021

Ndalohet riprodhimi i këtij botimi apo transmetimi i tij në cilëndo formë, pa autorizimin paraprak me shkrim të mbajtësit të së drejtës së autorit.

*Pikëpamjet e shprehura në këtë revistë janë të autorëve dhe nuk reflektojnë domosdoshmërisht ato të Institutit të Statistikave.

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. Vllazën Huta, Ndërtesa 35, Hyrja 1, Tiranë, Kodi Postar 1017

e-mail: INFOSTAT@instat.gov.al

Tel: +(355) 42222411

PËRMBAJTJA

- 5.** IMPLEMENTIMI I KORNIZËS PËR SIGURIMIN E CILËSISË BAZUAR NË KODIN E PRAKTIKËS TË STATISTIKAVE EVROPIANE
GERSA BALA, INSTITUTI I STATISTIKAVE
- 13.** AKTIVITETET E INOVACIONIT TË NDËRMARRJEVE NË SHQIPËRI
ENDRIT PREÇI, INSTITUTI I STATISTIKAVE
ADELINA VELO, INSTITUTI I STATISTIKAVE
- 22.** PËRSHTATJET METODOLOGJIKE TË IÇK DHE IHÇK NË KOHË PANDEMIE COVID-19
ALBAN LIKA, KOMBET E BASHKUARA
ERIK GJERMENI, KOMBET E BASHKUARA
ILIRJANA KRAJA, INSTITUTI I STATISTIKAVE
HAZBIE BUNGURI, INSTITUTI I STATISTIKAVE
- 34.** ANALIZA E MANGËSIVE LIGJORE ME RREGULLORET E BE–KAPITULLI 18
ESTELA KARAJ, INSTITUTI I STATISTIKAVE
- 39.** NON-RESPONSE TREATMENT IN HOUSEHOLD SURVEYS IN BOSNIA AND HERZEGOVINA
DAJANA MRGUD, AGENCY FOR STATISTICS OF BOSNIA AND HERZEGOVINA
JASNA ISAKOVIĆ, AGENCY FOR STATISTICS OF BOSNIA AND HERZEGOVINA
- 65.** IMPROVING THE QUALITY OF THE SBS DATA AND METHODS OF CALCULATION OF VARIABLES AND INDICATORS IN SBS
ALMA ČOLPA, INSTITUTE FOR STATISTICS OF FB&H

IMPLEMENTIMI I KORNIZËS PËR SIGURIMIN E CILËSISË BAZUAR NË KODIN E PRAKTIKËS TË STATISTIKAVE EVROPIANE

Gersa Bala¹

Abstrakt

Cilësia është një nga aspektet më të rëndësishme në Institutin e Statistikave të Shqipërisë (INSTAT).

INSTAT është i angazhuar për sigurimin e cilësisë në prodhimin e statistikave zyrtare duke implementuar një qasje më sistematike bazuar në rekomandimet e cilësisë dhe veçanërisht në përputhje me Kodin e Praktikës të Statistikave Evropiane.

Ky artikull përshkruan eksperiencën e implementimit të një Kornize të Sigurimit të Cilësisë bazuar në konceptin e cilësisë së Sistemit Evropian të Statistikave (ESS) dhe në parimet lidhur me cilësinë e produkteve statistikore sipas Kodit të Praktikës së Statistikave Evropiane.

Llogaritja e treguesve të cilësisë, përfshirë këto në raportet e cilësisë për disa produkte statistikore, zbatimi i një sistemi për metadata-t, realizimi i Anketës mbi Kënaqësinë e Përdoruesve si dhe përshtatja e Modelit të Procesit të Përgjithshëm Statistikor të Biznesit (GSBPM) janë disa nga veprimet e vëna në zbatim nga INSTAT.



Fjalë kyçe:

Korniza për Sigurimin e Cilësisë, Kodi i Praktikës së Statistikave Evropiane, standardet e cilësisë.

1. Instituti i Statistikave, Gbala@instat.gov.al



1. HYRJE

INSTAT, si institucioni kryesor prodhues i statistikave zyrtare dhe koordinatori i sistemit kombëtar statistikor, prodhon statistika asnjëanëse, transparente dhe të përditësuara, të cilat ndihmojnë në gjykimin e përdoruesve mbi proceset e zhvillimit e transformimit në fushat ekonomiko-sociale brenda vendit.

Vizioni i INSTAT-it është që të ofrojë të dhëna të besueshme dhe të krahasueshme, duke përshtatur metodologjitë dhe duke shtuar listën e treguesve statistikorë.

Për të siguruar cilësinë e statistikave zyrtare dhe besueshmërinë e publikut në to, INSTAT udhëhiqet nga parimet e Kodit të Praktikës së Statistikave Europiane (ESCP).

Qëllimi i këtij artikulli është të përshkruaj eksperiencën e implementimit të një Kornize të Sigurimit të Cilësisë bazuar në konceptin e cilësisë së Sistemit Evropian të Statistikave (ESS) dhe në parimet lidhur me cilësinë e produkteve statistikore sipas ESCP.

Një qasje sistematike në kuadër të cilësisë statistikore ka filluar të zbatohet nga viti 2013, siç u rekomandua nga Grupi i Ekspertëve për Cilësinë në kuadër të projektit “Vlerësimi i sistemeve statistikore dhe vendeve të zgjedhura për zgjerim” të financuar nga Eurostat, pasuar edhe nga dy misione të tjera vlerësimi “Peer Review”, në Korrik të vitit 2015 dhe Qershor 2018. Rezultati ishte një sërë veprimesh përmirësuese dhe progresive në implementimin e parimeve të Kodit të Praktikës Europiane, në lidhje me mjedisin institucional dhe shpërndarjen e statistikave cilësore.


Në vitin 2016, u krijua një strukturë e brendëshme, e përberë nga Koordinatorin për Cilësinë Statistikore dhe Sektorin e Cilësisë Statistikore. Krijimi i një njësie me kohë të plotë dedikuar çështjeve të cilësisë është një element kyç për monitorimin sistematik të cilësisë, si dhe përmirësime në planifikim, koordinim dhe komunikim i brendshëm.

Gjithashtu, u hartua dhe miratua Deklarata e Cilësisë së INSTAT si dhe Angazhimi për Cilësinë, dokumenta në dispozicion të publikut, të cilat parashtrojnë parimet dhe angazhimet që lidhen me cilësinë statistikore, në përputhje edhe me deklaratat e Misionit dhe Vizionit të INSTAT.

Së fundmi, janë bërë disa hapa në monitorimin dhe përmirësimin e cilësisë. Komiteti i Cilësisë mbledhet rregullisht që prej vitit 2019, duke asistuar në dizejnimin e kornizës së cilësisë dhe trajtimin e çështjeve në lidhje me fushën e cilësisë dhe standardeve të saj. Ky Komitet në bashkëpunim edhe me sektorët prodhues në INSTAT, ka kryer disa studime lidhur me treguesit dhe raportet e cilësisë, anketën e kënaqësisë së përdoruesve, modelin e proceseve statistikore, komunikimin e cilësisë tek përdoruesit dhe monitorimin sistematik të zbatimit të standardeve.

2. MENAXHIMI I PËRGJITHSHËM I CILËSISË

Gjatë vitit 2016-2017 INSTAT ka iniciuar shumë aktivitete lidhur me kornizën e menaxhimit të cilësisë në mënyrë që të përmirësohet pajtueshmëria me parimin 4 të Kodit të Praktikës për angazhimin e cilësisë (Eurostat, 2005). INSTAT ka studiuar modele dhe përvoja të ndryshme nga Shtetet Anëtare të BE si: TQM (Total Quality Management), Standardi ISO 9001, Modeli i Përsosmërisë EFQM dhe Scorecard Balanced dhe kanë vendosur të përdorë Menaxhimin e Përgjithshëm të Cilësisë (TQM), pasi ai është një model që ofron një shkallë të lartë fleksibiliteti, dhe i përdorur zyra të tjera statistikore. Me qëllim vendosjen e një niveli sa më të lartë të cilësisë, INSTAT ka ngritur një model menaxhimi në përputhje me parimet e Menaxhimit e Përgjithshëm të Cilësisë - TQM.



Baza për përgatitjen e strategjisë së përgjithshme të menaxhimit të cilësisë është përcaktimi i pesë parimeve në kuadër të të cilave INSTAT zhvillon fushën e cilësisë;

- Cilësi e mirë e proceseve dhe produkteve statistikore
- Përdorues të kënaqur me statistika zyrtare
- Ulja e ngarkesës së të anketuarve
- Përmirësimi i efektivitetit të proceseve statistikore
- Trajnimi dhe menaxhimi i njohurive


3. RAPORTET E CILËSISË PËRMES SISTEMIT TË METADATAVE

Një nga qëllimet kryesore të Komitetit të Cilësisë është të zhvillojë strategji për komunikimin me përdoruesit në përputhje me Kodin e Praktikës dhe cilësinë e statistikave evropiane, duke përbushur parimin “ Komunikimi me përdoruesit dhe grupet e interesit “.

INSTAT synon të ofrojë produkte dhe shërbime statistikore që korrespondojnë me nevojat statistikore të informacionit të grupeve të ndryshme të përdoruesve. Përmirësimi i cilësisë së informacionit statistikor kryhet vazhdimisht duke kërkuar kostot më të ulëta të mundshme dhe duke zvogëluar barrën e përgjigjes.

Raportet e Cilësisë janë realizuar për 51 produkte statistikore. Nëpërmjet tyre, përdoruesve u sigurohet informacion me format standard në metodat dhe përkufizimet e aplikuara dhe në cilësinë e rezultateve statistikore. Në figurën më poshtë jepet progresi i Raporteve të Cilësisë prej vitit 2017 e në vazhdim. Në vitin 2021, janë publikuar 2 herë më shumë raporte cilësie krahasuar me vitin 2017.

Figura 2 : Numri i Raporteve të Cilësisë të publikuara, 2017-2021



Struktura e Raporteve të Cilësisë bazohet në konceptin e cilësisë së Sistemit Evropian të Statistikave (ESS) dhe në parimet lidhur me cilësinë e produkteve statistikore sipas Kodit të Praktikës së Statistikave Evropiane.

Gjithashtu, raportet e cilësisë të orientuara nga përdoruesi ose ato të orientuara nga prodhuesi, duhet të bazohen në nevoja specifike dhe të ndryshme. Përdoruesit e statistikave zyrtare duhet të kenë qasje në një varg vlerësimesh dhe treguesish të cilësisë përkatëse për të kuptuar pikat e forta, kufijtë e statistikave dhe për të ditur se si t'i përdorin ato siç duhet. Nga ana tjetër, prodhuesit duhet të kenë një pamje mbi cilësinë e produktit për të parë rezultatet e zhvillimeve të mëparshme të prodhimit dhe për të identifikuar pikat e përmirësimeve të mëtejshme. Në përbushje të këtij qëllimi, përgatitja e raporteve të cilësisë bëhet duke respektuar gjashtë kriteret bazë të cilësisë: (rëndësia, saktësia, afati dhe përpikmëria, qasja dhe qartësia, krahasueshmëria dhe koherenca).

Ekziston një nevojë e qartë për reduktimin dhe thjeshtimin e formateve të ndryshme të raportimit të cilësisë. Për Metadata referenciale, INSTAT ka implementuar si standard versionin SIMS 2.0. Në vazhdim të kësaj, INSTAT ka zhvilluar një sistem të brendshëm të integruar, IMS, i cili përdoret për të prodhuar metadata dhe raporte të cilësisë (ESMS dhe ESQRS) në shqip dhe anglisht. Sistemi IMS është thelbësor në arritjen e qëllimeve për plotësimin e nevojës së Eurostat dhe përdoruesve shqiptarë në një mënyrë të qëndrueshme dhe efikase. INSTAT realizon transmetimin e këtyre raporteve në EUROSTAT nëpërmjet aplikacionit ESS Metadata Handler.

Nën cilësinë e institucionit përgjegjës për drejtimin e Sistemit Kombëtar Statistikor, INSTAT do të vazhdojë të përdorë standardet e përcaktuara për metadatat strukturore dhe referenciale që disponon në institucion si dhe do të transferojë në Eurostat metadatën në përputhje me standardin evropian për të gjitha fushat e prodhimit statistikor. Gjithashtu publikimi në faqen e web-it të INSTAT i raporteve të metadata-ve sipas fushave të prodhimit statistikor do të ndikojë në transparencën e prodhimit statistikor dhe forcimin e marrëdhënies me përdoruesit. Rritja e kapaciteteve në lidhje me prodhimin e metadatave dhe raporteve të cilësisë për agjencitë e tjera statistikore është një tjetër synim i INSTAT.

4. ANKETA MBI KËNAQËSINË E PËRDORUESVE

Anketa mbi Kënaqësinë e Përdoruesve është mjet tradicional për menaxhimin e cilësisë. Kodi i Praktikës e përfshin këtë mjet në dy indikatorë, Indikatori 4.3: (Cilësia e produktit monitorohet rregullisht, vlerësohet duke konsideruar balancat e mundshme dhe raportohet sipas kriterëve të cilësisë për Statistikat Evropiane) dhe Indikatori 11.3: (Kënaqësia e përdoruesit monitorohet rregullisht dhe ndiqet në mënyrë sistematike)

INSTAT ka zhvilluar Anketën mbi Kënaqësinë e Përdoruesve që prej vitit 2017 e në vazhdim. Anketa është realizuar mbi të dhënat e përdoruesve që kanë kërkuar statistika pranë INSTAT nga viti 2009 e deri në vazhdim. Pyetësi është dërguar me e-mail tek përdoruesit, por gjithashtu linqet për plotësimin e tij u vendosën në faqen zyrtare të INSTAT si dhe në faqen zyrtare të Facebook, kështu që çdo përdorues i interesuar të mund të merrte pjesë në këtë anketë.

Pyetësi përgatitet në Shqip dhe Anglisht dhe përmban 12 pyetje. Në disa pjesë të pyetësit përdoruesit mund të shkruanin propozimet dhe sugjerimet e tyre mbi përmirësime të mundshme. Pyetësi mbulon temat e mëposhtme: Karakteristikat demografike të përdoruesve, përdorimin dhe cilësinë e të dhënave statistikore, kënaqësinë ndaj faqes online të INSTAT, kënaqësinë me punonjësit dhe cilësinë e shërbimit, si dhe pyetje mbi ndjekjen e INSTAT në rrjetet sociale.

Në vijim të përmirësimit të cilësisë statistikore, INSTAT do të kryejë vlerësime periodike nëpërmjet matjes së kënaqësisë së përdoruesve dhe kënaqësisë së punonjësve.

5. PËRMIRËSIMI I EFEKTIVITETIT TË PROCESEVE STATISTIKORE

5.1 Modeli gjenerik i proceseve të prodhimit të statistikave gsbpm

Statistikat e prodhuara duke ndjekur standardin GSBPM ndikojnë drejtpërdrejtë në cilësinë e tyre pasi sistemi ndihmon në planifikimin dhe monitorimin e proceseve të mbledhjes, përpunimit dhe publikimit të statistikave në çdo hap të tij. Standardi GSBPM po aplikohet në pjesën më të madhe të sistemeve statistikore ndërkombëtare. Në këtë kuadër edhe INSTAT ka përfshirë në Programin 5-vjeçar për Statistikat Zyrtare 2017-2021 zbatimin e GSBPM, i cili do të përdoret për vlerësimin, përshkrimin dhe dokumentimin e të gjitha proceseve statistikore të nevojshme për prodhimin e statistikave zyrtare. Modeli GSBPM duke qenë i lidhur ngushtë me menaxhimin e cilësisë, siguron një kornizë për vlerësimin e cilësisë. Si një qasje standarde për vlerësimin e cilësisë, është e nevojshme të standardizohen proceset e këtij modeli sa më shumë që të jetë e mundur. Modeli është krijuar që të jetë i pavarur nga burimi i të dhënave, kështu që mund të përdoret për përshkrimin dhe vlerësimin e cilësisë së proceseve të bazuara në anketime, regjistrime, regjistrime administrative dhe burime të tjera jo statistikore ose të përziera, si dhe për vlerësimin e kostove/ burimeve njerëzore. INSTAT gjatë vitit 2022, me vendim të Bordit të Drejtorëve, do të aplikojë versionin e përditësuar të GSBPM v5.1.

5.2 Udhëzuesi i cilësisë

Qëllimi i dokumentit të Udhëzuesit të Cilësisë është përshkrimi dhe udhëzimi për zbatimin e duhur të përshkrimit të proceseve statistikore të kryera nga INSTAT. Përgatitja e Udhëzuesit të Cilësisë ku është përcaktuar se si të implementohet menaxhimi i cilësisë brenda procesit të prodhimit statistikor, përfshin: një përshkrim të procesit të prodhimit statistikor dhe identifikimin e dokumentimit për secilën fazë, si dhe përshkrimi i metodave për të monitoruar cilësinë e çdo fazë të procesit të prodhimit statistikor.

Drafti i parë i këtij dokumenti është bërë në vitin 2018, duke u mbështetur mbi Kodin e Praktikës si dhe në përputhje me versionin GSBPM 5.0. Gjatë 2021 u përgatit dokumenti i përditësuar i Udhëzuesit të Cilësisë sipas modelit GSBPM 5.1., i cili do të përdoret në vazhdimësi për kontrollin dhe vlerësimin e aktiviteteve statistikore.

6. PËRFUNDIME

INSTAT punon në kuadër të proceseve të mirë-strukturuara dhe në koherencë me planin vjetor të punës. Treguesit e cilësisë dhe faktorët e tjerë të rëndësishëm në lidhje me procesin e prodhimit statistikor si dhe rezultatet e tij janë të përcaktuara mirë dhe kontrollohen vazhdimisht.

Statistikat përcaktohen sipas nevojave të përdoruesve, të publikuara në seri kohore, në mënyrë të përpiktë dhe të paraqitura në një formë të qartë dhe të kuptueshme. Pavarësia profesionale e INSTAT është e përcaktuar me ligj, i cili garanton që statistikatat duhet të zhvillohen, të prodhohen dhe të shpërndahen në mënyrë të pavarur, veçanërisht për sa i takon zgjedhjes së teknikave, përkufizimeve, metodologjive dhe burimeve të të dhënave, kohës dhe formës së shpërndarjes, pa trysinë e grupeve politike, grupeve të interesit apo autoriteteve shtetërore.

Me drejtimin e duhur menaxherial, si dhe duke përfituar nga proceset monitoruese të Eurostat-it, Instituti i Statistikave dhe agjencitë e tjera statistikore do të vazhdojë punën në përmirësimin e Kornizës së Sigurimit të Cilësisë dhe implementimin e mëtejshëm të Kodit të Praktikës Europiane.

REFERENCA

1. LIGJ Nr. 17/2018 - PËR STATISTIKAT ZYRTARE
http://instat.gov.al/media/3973/ligj-nr-17-dt-542018_per-statistikat-zyrtare.pdf
2. Cilësia Statistikore në INSTAT
<http://instat.gov.al/al/dokumentimi/cil%C3%ABsia-statistikore/>
3. Kodi i Praktikave të Statistikave Europiane
<https://ec.europa.eu/eurostat/documents/4031688/8971242/KS-02-18-142-EN-N.pdf/e7f85f07-91db-4312-8118-f729c75878c7>
4. REGULATION (EC) No 223/2009 OF THE EUROPEAN PARLIAMENT AND OF THE COUNCIL
<https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32009R0223&from=EN>
5. ISO 9000: 2015 Sistemet e menaxhimit të cilësisë - Bazat dhe fjalori
<https://www.iso.org/obp/ui/>
6. Raportet e Cilësisë/ Metadata Referenciale:
<http://instat.gov.al/al/dokumentimi/cil%C3%ABsia-statistikore/raportet-e-cil%C3%ABsis%C3%AB/>
7. ESS QUALITY AND PERFORMANCE INDICATORS (QPI)
<https://ec.europa.eu/eurostat/documents/64157/4373903/02-ESS-Quality-and-performance-Indicators-2014.pdf/5c996003-b770-4a7c-9c2f-bf733e6b1f31>
8. European Statistical System handbook for quality and metadata reports, 2020 edition
<https://ec.europa.eu/eurostat/documents/3859598/10501168/KS-GQ-19-006-EN-N.pdf>
9. Light Peer Review of the Implementation of the European Statistics Code of Practice in the Republic of Albania, 2014
http://instat.gov.al/media/2832/lpr_report_final_version_2014-09-04_complete.pdf
10. Peer review report on compliance with the code of practice and the coordination role of the national statistical institute
<http://instat.gov.al/media/4969/peer-review-report-albania2018.pdf>

AKTIVITETET E INOVACIONIT TË NDËRMARRJEVE NË SHQIPËRI

Endrit Preçi¹

Adelina Velo²

Abstrakt

Përgjatë viteve, Inovacioni ka ndikuar ndjeshëm në zhvillimin e shoqërive njerëzore dhe mjedisin rreth tyre. Aktiviteti i inovacionit përfshin të gjitha aktivitetet zhvillimore, financiare dhe tregtare, të ndërmarra nga një ndërmarrje, të cilat synojnë ose rezultojnë në një inovacion. Aktivitetet e inovacionit, shpenzimet për inovacion, inovacionet e produkteve dhe proceseve, shitjet neto nga produktet inovative dhe bashkëpunimi për inovacion janë indikatorë të rëndësishëm për politikëbërjen, duke siguruar informacion për rritjen ekonomike, produktivitetin, si dhe krahasueshmërinë statistikore midis vendeve. Në vendin tonë, kërkesa për treguesit statistikorë të Inovacionit është e lartë, duke qenë se Kërkimi Shkencor, Teknologjia dhe Inovacioni konsiderohen si prioritete të rëndësishme kombëtare për zhvillimin e sektorëve socialë, ekonomikë dhe kulturorë të vendit. Në këtë artikull do të parashtrihen vlerësimet e vrojtimeve të zhvilluara nga Instituti i Statistikave (INSTAT) në ndërmarrjet e sektorit financiarë dhe jo-financiarë me 10 ose më shumë të punësuar, duke marrë parasysh parimin e cilësisë statistikore për të dhënat e prodhuara.



Fjalë kyçe:

Inovacion, aktivitetet e inovacionit në ndërmarrje, inovacion produkti dhe procesi biznesi.

1. Instituti i Statistikave, epreci@instat.gov.al

2. Instituti i Statistikave, avelo@instat.gov.al


1. HYRJE

Inovacioni është motorr për rritjen ekonomike në çdo ekonomi. Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillimin Ekonomik (OBZHE) përcakton një inovacion si një produkt ose proces të ri ose të përmirësuar (ose kombinimi i tyre) që ndryshon në mënyrë të konsiderueshme nga produktet ose proceset e mëparshme të njësisë dhe që është vënë në dispozicion të përdoruesve të mundshëm (produkti) ose është sjellë në përdorim nga njësia (procesi) (OBZHE, 2010).

Aktivitetet e inovacionit përfshijnë të gjitha aktivitetet zhvillimore, financiare dhe tregtare të ndërmarra nga një ndërmarrje, të cilat synojnë ose rezultojnë në një inovacion.

Nga perspektiva e procesit, aktiviteti i inovacionit kërkon zhvillimin pjesërisht të disa veprimeve si identifikimi i nevojave teknike dhe teknologjike, gjenerimi i ideve për zgjidhjen e problemeve, zgjedhja e idesë më të mirë, krijimi i konceptit të zgjidhjes dhe zgjedhja e konceptit më të mirë, zgjidhja e problemit sipas konceptit të zgjedhur, realizimi i projektit, krijimi i inovacionit dhe komercializimin (Figura 1). Nga pikëpamja ekonomike e një ndërmarrje, në rastin e një inovacioni produkti, një fazë shumë e rëndësishme është dhe komercializimi i produktit e cila mund të përfshijë implementim të shpejtë në treg të një inovacion produkti të ri ose të përmirësuar, fazë e cila kërkon një mbështetje të madhe financiare.

Figura 1. Fazat e procesit të krijimit të inovacionit



Zhvillimi i një inovacioni produkti ndryshon në varësi të ekonomisë ku ky produkt zhvillohet. Vendet në zhvillim për shkak të nivelit të ulët të të ardhurave, pamjaftueshmërisë së njohurive si dhe teknologjisë, hasen me pengesa të shumta për prezantimin e një inovacion produkti. Identifikimi i pengesave që ngadalësojnë ose ndalojnë procesin e finalizimit të një produkti

inovacioni është i rëndësishëm për matjen e efekteve të tyre në rezultatin final të procesit të inovacionit. Pengesat mund të jenë të brendshme (burimet, fondet, ekspertiza, menaxhimi, etj.) dhe të jashtme (ofertë, kërkesë dhe mjedis).

Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (NVM), në vendet e industrializuara, priten për t'u përballur me më shumë pengesa për zhvillimin e aktiviteteve të inovacionit sesa ndërmarrjet e mëdha për shkak të burime dhe ekspertizës së pamjaftueshme të brendshme. Kjo është arsyeja pse më shumë theks u është dhënë NVM-ve në studimin e pengesave të tyre ndaj inovacionit (Nassar.M, 2015). E megjithëse vështirësi më shumë në zhvillimin e një inovacioni procesi paraqesin ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, në vendet në zhvillim nuk përjashtohen as ndërmarrjet e mëdha të cilat pengesë të këtij procesi mund të ketë fazën e komercializimit ose dhe të aftësive dhe njohurive nga fuqia punëtore për implementimin e një inovacioni të ri. Të njëjtën analizë kanë ndjekur dhe shumë studiues të tjerë, por me argumentime të ndryshme. Rogers (2003) citon një numër studimesh që tregojnë se ndërmarrjet më të mëdha kanë më shumë gjasa të jenë novatore sesa ato më të vogla. Sidoqoftë, ai e zvogëlon disi rëndësinë e këtij treguesi, duke sugjeruar që madhësia është një treguesi i thjeshtë për t'u përdorur dhe sugjeron që ka variabla të tjerë të rëndësishëm, të cilët ndoshta nuk kuptohen mirë dhe përdoren rrallë si tregues. Bizneset e vogla kanë më pak para dhe për këtë arsye më pak për të investuar në inovacion. Marrëdhëniet midis sjelljes novatore dhe performancës së ndërmarrjeve janë shumë të rëndësishme.

Inovacioni i ndihmon kompanitë të rriten. Rritja shpesh matet në termat të xhiros dhe fitimit, por gjithashtu kjo rritje mund të ndodhë në njohuri, në përvojën njerëzore dhe në efikasitet dhe cilësi.

Ndërsa Shqipëria po përpiqet të vazhdojë me rritjen ekonomike, është e rëndësishme që vendi të zhvillojë konkurrueshmërinë e sektorit të tij privat. Ka shumë tregues që tregojnë se Shqipëria nuk do të jetë në gjendje të ndërtojë konkurrencën e saj bazuar në pagat e ulëta, kështu që, përmirësimi i konkurrencës përmes njohurive dhe inovacionit në përgjithësi do të jetë çelësi i suksesit. Prandaj, qëllimi është fillimi i transformimit të vendit në një ekonomi të bazuar në dije, e aftë të konkurrojë në tregjet ndërkombëtare përmes fuqisë punëtore të aftë dhe kompanive novatore. Duke pasur parasysh disponueshmërinë e kufizuar të burimeve dhe nevojën për të zhvilluar një masë kritike të burimeve dhe kompetencave për të arritur konkurrencën në nivel ndërkombëtar, një strategji për "specializim të zgjuar" siguron një bazë të shëndoshë për ndërtimin e një sistemi inovator kombëtar.

Për të siguruar informacion në lidhje me aktivitetet e inovacionit në ndërmarrje përdoren anketat statistikore të cilat potencialisht japin të dhëna sasiore dhe cilësore për këtë lloj aktiviteti. Në Shqipëri si burim kryesorë për statistikën e inovacionit është INSTAT, i cili kryen anketa të rregullta në lidhje me statistikën e shkencës, teknologjisë dhe inovacionit.

Anketa e Inovacionit siguron informacion në lidhje me prirjen dhe aftësinë e ndërmarrjeve shqiptare për të prezantuar produkte, procese, praktika organizative ose metoda marketingu të reja ose të përmirësuara. Konceptet dhe përkufizimet e përdorura në anketën e inovacionit në ndërmarrje janë përcaktuar si më poshtë:

Një inovacion: Është një produkt ose proces i ri ose i përmirësuar (ose kombinimi i tyre) që ndryshon në mënyrë të konsiderueshme nga produktet ose proceset e mëparshme të njësisë dhe që është vënë në dispozicion të përdoruesve të mundshëm ose është sjellë në përdorim nga njësia.

Ndërmarrje aktive në inovacion: Një ndërmarrje e angazhuar gjatë periudhës së vëzhgimit, në një ose më shumë aktivitete për të zhvilluar ose prezantuar produkte të reja ose të përmirësuara ose procese biznesi për një përdorim të synuar. Gjatë periudhës së vëzhgimit mund të jenë aktive në inovacion si ndërmarrjet novative apo ndërmarrjet jo-novative.

Një inovacion produkti: Është implementimi i një malli apo shërbimi që është i ri ose i përmirësuar dhe që ndryshon ndjeshëm nga mallrat ose shërbimet e mëparshme të ndërmarrjes. Ai përfshin ndryshime të rëndësishme të konstruktit të mallrave.

Një inovacion procesi biznesi: Është një proces biznesi i ri ose i përmirësuar për një ose më shumë funksione biznesi që ndryshon ndjeshëm nga proceset e mëparshme të biznesit të ndërmarrjes dhe i cili është zbatuar brenda firmës. Inovacionet e procesit të biznesit përfshijnë metoda të reja ose të përmirësuara për: prodhimin e mallrave ose ofrimin e shërbimeve; shpërndarjes, furnizimit ose logjistikës; komunikimin dhe përpunimin e informacionit; kontabilitetit dhe operacioneve të tjera administrative; praktika biznesi për organizimin e procedurave ose marrëdhënieve me jashtë; organizimit të përgjegjësisë në punë, vendimmarrjes dhe menaxhimit të burimeve njerëzore, marketingut për promovim, paketim, çmim, vendosje të produktit ose shërbime pas shitjes.

Inovacionet duhet të jenë të reja për ndërmarrjen në fjalë, por jo domosdoshmërisht duhet të jenë të reja në treg, d.m.th. ndërmarrja nuk ka pse të jetë domosdoshmërisht e para që ka prodhuar këto produkte (mallra ose shërbime) ose ka futur këto procese biznesi.

Aktiviteti i inovacionit: Përfshin të gjitha aktivitetet zhvillimore, financiare dhe tregtare, të ndërmarra nga një ndërmarrje, të cilat synojnë ose rezultojnë në një inovacion.

Anketa e Inovacionit zhvillohet si pjesë e statistikave të përbashkëta të Bashkimit Evropian (BE) dhe vendeve të tjera. Kjo anketë filloi në vitin 1992 dhe statistikën fillimisht prodhoheshin çdo katër vjet. EUROSTAT (zyra statistikore e BE -së) ka krijuar sistemin për mbledhjen dhe prodhimin e këtyre statistikave në bashkëpunim me vendet që kryejnë anketën dhe në konsultim me OBZHE.

Anketa është pjesë e anketës së Inovacionit që zhvillojnë vendet europiane (Community Innovation Survey-CIS), e cila është zhvilluar gradualisht që nga anketa e parë e Inovacionit (CIS1), e ndërmarrë me 1992 si vit reference. CIS2 u krye për vitin 1997, CIS3 për 2001 dhe CIS4 për 2004 e kështu me rradhe çdo 2 vjet.

Përdoruesit dhe aplikimet

Përdoruesit kryesorë janë administrata publike, Akademia e shkencave, studiuesit, organizatat dhe ndërmarrjet. Anketa është e rëndësishme për vlerësimin e politikës së inovacionit dhe politikave industriale në përgjithësi. Statistikat përdoren gjithashtu nga Eurostat dhe OBZHE për krahasime ndërkombëtare

Popullata

Në anketim përfshihen të gjitha ndërmarrjet e sektorit jo-financiarë dhe financiarë me 10 ose më shumë të punësuar të angazhuar kryesisht në aktivitetet e mëposhtme ekonomike (NVE Rev. 2): Industria nxjerrëse dhe përpunuese; Energji elektrike, uji dhe menaxhimi i mbetjeve, Tregtia me shumicë, përveç automjeteve dhe motoçikletave; Transporti dhe magazinimi; Informacioni dhe komunikacioni; Aktivitetet Financiare dhe Sigurimit; Aktivitete arkitektonike dhe inxhinierike; testimi dhe analiza teknike; Aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike; Publiciteti dhe kërkimet e tregut.

Burimet e të dhënave dhe kampionimi

Anketa kryhet duke përdorur Regjistrin Statistikor të Ndërmarrjeve si një kornizë kampionimi. Për matjen e aktiviteteve të Inovacionit në ndërmarrje, INSTAT ka intervistuar 1,575 ndërmarrje të të gjitha formave ligjore dhe llojeve të pronësisë me 10 e më shumë të punësuar në vitin 2020.

Mbledhja e të dhënave, redaktimi dhe vlerësimet

Mbledhja e të dhënave për anketën e inovacionit kryhet përmes pyetësorit letër. Koncepti i inovacionit, për disa ndërmarrje, mund të jetë i vështirë për t'u interpretuar dhe dalluar nga aktivitetet e ndërlidhura. Shkalla e përgjigjes për anketën është e lartë > 80 përqind.

2. TË DHËNAT


Çdo kompani që dëshiron të arrijë një avantazh konkurrues dhe të maksimizojë fitimet (që është gjithashtu qëllimi kryesor i çdo biznesi) duhet që në të ardhmen e saj të afërt të përfshijë inovacione në aktivitetin e tyre. Që kompanitë të rriten dhe të vazhdojnë të jenë të suksesshme, inovacioni është vendimtarë. Për të kuptuar nivelin e përdorimit të inovacionit, vitet e fundit janë kryer disa anketa në ndërmarrjet private në Republikën e Shqipërisë. Rezultatet e anketave të tilla kanë çuar në përfundime të caktuara në lidhje me zbatimin e inovacionit në ndërmarrje. Shumica e ndërmarrjeve të anketuara pjesëmarrëse në anketa i përkasin sektorit të industrisë përpunuese dhe tregtisë, dhe sipas numrit të të punësuarve, shumica e tyre i përkasin kategorisë së NVM. Kjo për faktin se shumica e kompanive shqiptare, si dhe kompanitë në vendet e tjera në tranzicion, janë ende në zhvillim, si në lidhje me procesin e prodhimit ashtu edhe me numrin e të punësuarve.

INSTAT ka kryer deri tani dy publikime në lidhje me statistikën e aktiviteteve të inovacionit në ndërmarrje. Publikimi i parë është bërë në Nëntor 2020 me periudhë referuese vitet 2017-2018-2019 (3 vite së bashku). Për të qënë në përputhje me vendet e BE (zhvillohet anketa e inovacionit në të gjitha vendet antare për të njëjtën periudhë referuese) është bërë një publikimi në Qershor 2021 me periudhë referuese 2018-2019-2020 (3 vite së bashku). Duke

qënë se ka mbi-vendosje periudhash referuese, nuk mund të bëhen krahasime të mirëfillta të serive kohore. Por për efekt të këtij materiali informues do të krahasohen të dhënat e dy publikimeve që janë bërë nga INSTAT.

Gjatë periudhës 2018-2020, 36,6 % e ndërmarrjeve të vrojtura kryen një aktivitet Inovacioni. Aktiviteti i Inovacionit rezultoi më i lartë në ndërmarrjet që operojnë në sektorin e shërbimeve me 41,0 %, krahasuar me ndërmarrjet në sektorin e Industrisë me 32,1 % (Tab.1). Krahasuar me të dhënat e vrojtimit të mëparshëm të inovacionit me periudhë referuese 2017-2019, aktiviteti i inovacionit u ul me 1,7 % (nga 38,3 % në 36,6 %). Kjo rënie u vu re në ndërmarrjet në sektorin e industrisë dhe në atë të shërbimeve me përkatësisht 2,0 % dhe 1,3 %. Aktiviteti i inovacionit rezultoi më i pranishëm në grupin e ndërmarrjeve të mëdha, me mbi 250 të punësuar me 68,2 %, kjo tendencë vihet re edhe në publikimin e mëparshëm me periudhë referuese 2017-2019. Në vitin 2020, shitjet neto të realizuara nga ndërmarrjet aktive në Inovacion përbënë 55,9 % të shitjeve neto gjithsej të ndërmarrjeve të vrojtura ndërsa numri i të punësuarve në këto ndërmarrje rezultoi 51,9 % (Figura 2).

Figura 2: Treguesit e shitjeve neto dhe të punësuarit për ndërmarrjet aktive në inovacion sipas aktivitetit ekonomik dhe madhësisë së ndërmarrjes, 2020



Burimi: INSTAT

Gjatë periudhës 2018-2020, 23,6 % e të gjitha ndërmarrjeve të vrojtura zhvilluan inovacione të produkteve (mallra ose shërbime të reja ose të përmirësuara) në krahasim me 25,3 % gjatë periudhës referuese 2017-2019, ndërsa 31,6 % zhvilluan procese biznesi të reja ose të përmirësuara, në krahasim me 32,9 % gjatë periudhës referuese 2017-2019.


Nga ndërmarrjet me inovacione të produkteve, 37,2 % e tyre zhvilluan mallra të reja ose të përmirësuara dhe 31,4 % e ndërmarrjeve zhvilluan shërbime të reja ose të përmirësuara. Ndërsa ndërmarrjet që zhvilluan së bashku mallra dhe shërbime të reja ose të përmirësuara rezultuan 31,4 %.

Gjatë periudhës 2018-2020, 42,0 % e ndërmarrjeve me Inovacione produktesh prezantuan mallra ose shërbime që ishin të reja jo vetëm për ndërmarrjen, por edhe për tregun (jo të ofruara më parë nga konkurrentët e tyre), në krahasim me 35,4 % të periudhës referuese 2017-2019. Për të kryer aktivitetin e tyre të inovacionit, 25,9 % e ndërmarrjeve aktive në Inovacion ishin të

përfshirë në bashkëpunim me ndërmarrje të tjera, organizata shkencore dhe partnerë të tjerë. Për ndërmarrjet me mbi 250 të punësuar, kjo përqindje rezultoi 38,1 %. Gjatë periudhës 2018-2020, 13,1 % e ndërmarrjeve të vrojtura kanë blerë makineri, pajisje ose mjete programuese të bazuar në teknologji të re që nuk ishte përdorur më parë nga këto ndërmarrje, në krahasim me 11,3 % gjatë periudhës referuese 2017-2019. Gjatë periudhës 2018-2020, 3,6 % e ndërmarrjeve aktive në inovacion morën mbështetje financiare nga autoritetet publike, ndërsa 1,6 % ndërmarrjeve që nuk kryen ndonjë inovacion morën mbështetje financiare publike.

Krahasuar me vendet Bashkimit Evropian ndërmarrjet shqipëtare janë më aktive në inovacion se ndërmarrjet Romune, Polake, Hungareze apo Portugeze. Më poshtë jepet një grafik (Figura 3) ku pasqyrohen të dhënat në përqindje sipas shteteve të BE dhe Shqipërisë. Duhet mbajtur parasysh se të dhënat e fundit të publikuara nga EUROSTAT në lidhje me statistikat e inovacionit për shtetet antare të BE janë për vitet referencë 2016-2018, ndërsa të dhënat në lidhje me Shqipërinë që i përafrohen këtij viti referencë janë për vitet referencë 2017-2019.

Figura 3: Ndërmarrjet me aktivitete inovative në 2016-2018 sipas shteteve të BE.



Burimi: EUROSTAT dhe INSTAT

3. PËRFUNDIME

Aplikimi i Inovacionit është një detyrë komplekse dhe e vështirë. Inovacioni i cili përcaktohet përafërsisht si prezantimi i parë i një shpikje në treg ka për detyrë të sigurojë fuqi konkurruese si për kompanitë ashtu edhe për vendet duke rritur cilësinë e jetës dhe duke kontribuar në pasurinë e shteteve. Duke pasur parasysh rëndësisë e inovacionit si për bizneset ashtu edhe për vendet, matja e aktiviteteve inovatore është shumë e rëndësishme, veçanërisht në vendet e industrializuara. Rezultatet e anketave tregojnë se kompanitë në Shqipëri nuk janë shumë inovatore. Angazhimi politik në kuadrin e politikave është shumë i rëndësishëm për teknologji dhe inovacion. Siç dihet K&ZH është një element kyç në një ekonomi të bazuar në njohuri. Prandaj, tregues si K&ZH përdoren për matjen e inovacionit në kompani. Sidoqoftë, K&ZH është vetëm një pjesë e inovacionit, madje në vendet e zhvilluara inovacioni është më i rëndësishëm se K&ZH. Ekziston gjithashtu përhapja e njohurive dhe aftësive termi i inovacionit, të cilat nuk merren parasysh nga K&ZH në vendet në zhvillim.

REFERENCA

1. EUROSTAT webfaqe. Community innovation survey. Enterprises with innovation activities during 2016 and 2018.
https://ec.europa.eu/eurostat/databrowser/view/inn_cis11_inact/default/table?lang=en.
2. Freeman, C. (1982). The economics of industrial innovation. Academy for Entrepreneurial Leadership Historical Research Reference in Entrepreneurship. University of Illinois, Urbana.
3. INSTAT webfaqe. Inovacioni.
<http://instat.gov.al/al/temat/shkenc%C3%AB-teknologji-dhe-inovacion/inovacioni/>.
4. Organizata për bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OBZHE), (2010), “Matja e aktiviteteve shkencore dhe teknologjike: udhëzime për mbledhjen dhe interpretimin e të dhënave të inovacionit teknologjik.”
5. Piatier, A. (1984). Barriers to innovation. Frances Printer, London.
6. Rush, H., & Bessant, J. (1992). Revolution in three-quarter time: Lessons from the diffusion of advanced manufacturing technologies. Technology Analysis and Strategic Management, 4 (1), 3– 19.

PËRSHTATJET METODOLOGJIKE TË IÇK DHE IHÇK NË KOHË PANDEMIE COVID-19

Alban Lika¹

Erik Gjermani²

Ilirjana Kraja³

Hazbie Bunguri⁴

Abstrakt

Vendosja e masave kufizuese për shkak të pandemisë së Covid-19 ndikoi jashtëzakonisht në disponueshmërinë e të dhënave dhe mënyrën se si statistikat zyrtare mbledheshin dhe shpërndanin informacionin statistikor. Ngadalësimi i aktiviteteve ekonomike të shkaktuara nga bllokimet dhe masat e distancimit social e vendosi Institutin e Statistikave (INSTAT) përballë disa sfidave, veçanërisht në mbledhjen e të dhënave për të prodhur Indeksin e Çmimeve të Konsumit (IÇK) dhe Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit (IHÇK). Për të kapërcyer këtë situatë të paprecedentë, Eurostat nxorri disa udhëzime dhe sugjerime metodologjike për mbledhjen e të dhënave dhe për teknikat e imputimit për të siguruar vazhdimësinë e prodhimit të IÇK-së dhe IHÇK-së. Ky artikull përshkruan vështirësitë kryesore që INSTAT ka hasur në mbledhjen e çmimeve të produkteve për prodhimin e IÇK-së dhe IHÇK-së dhe ilustron sesi INSTAT u përball dhe menaxhoi këto sfida. Së fundi, studimi thekson se zyrat statistikore duhet të jenë vigjilente në rregullimet metodologjike për të përballuar krizën aktuale dhe kriza në të ardhmen.



Fjalë kyçe:

Covid-19, të dhëna statistikore, IÇK dhe IHÇK, imputime.

1. Kombet e Bashkuara, a.likal@yahoo.com

2. Kombet e Bashkuara, gjermanie@yahoo.com

3. Instituti i Statistikave, ikraja@instat.gov.al

4. Instituti i Statistikave, hbunguri@instat.gov.al



1. HYRJJE

Përhapja e Covid-19 gjeti shumicën e vendeve të papërgatitura për të vepruar shpejt ndaj pasojave të një dukurie të tillë të paprecedentë. Vendet si një mënyrë për të frenuar përhapjen e virusit ishin të detyruara të vendosnin masa kufizuese ekstreme deri në mbyllje. Edhe Shqipëria, pas shfaqjes së rastit të parë të infektimit më 9 Mars 2020, paralajmëroi komunitetin e saj për masat e sigurisë dhe kufizuese dhe informoi për praninë e rasteve të infektuarve në vend (MSHMS, 2020a). Vazhdimi i rritjes së numrit të rasteve të infektimeve detyroi Qeverinë Shqipëtare, në koherencë me protokollet e Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSh), të intensifikojë masat kufizuese me qëllim zbutjen e rrezikut të përhapjes së rasteve të infektimit. Kështu, në datën 20 Mars 2020, Qeveria e Shqipërisë dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale prezantuan masat e reja kufizuese për parandalimin e përhapjes së virusit (MSHMS, 2020b).

Masat parandaluese patën një ndikim masiv në aktivitete të shumta dhe ekspozuan një ngadalësim të shpejtë të ekonomisë. Rënia e rasteve të infektimeve dhe shkalla e ulët e vdekjeve gjatë tremujorit të dytë të 2020 e shtyu qeverinë drejt zbutjes së masave parandaluese të virusit dhe u duk se vendi u kthye në një ekonomi të ringjallur që tregoi shenja rimëkëmbjeje në fillim të tremujorit të tretë të vitit 2020. Lehtësimi i masave kufizuese gjatë tremujorit të dytë dhe të tretë të vitit 2020, kërcënoi qëndrueshmërinë e arritur deri tani për tejkalimin e situatës pandemike. Rishfaqja e Covid-19 tregoi një rritje të rasteve të infektuara gjatë muajve Nëntor-Dhjetor 2020 dhe rritje e cila vazhdoi dhe gjatë vitit 2021. Rrethana të tilla e detyruan qeverinë të rivendosë orën policore dhe vazhdimësinë e tyre gjatë gjithë vitit 2021 deri në njoftimin e mëtejshëm. Për më tepër, zbulimi i variantit të ri të virusit në Mbretërinë e Bashkuar dhe Brazil gjatë muajve Nëntor - Dhjetor 2020 shtoi pasigurinë për të parashikuar tendencat e ardhshme të pandemisë dhe kërcënoi rimëkëmbjen e sektorëve të ekonomisë. Masat parandaluese të ndërmarra nga Qeveria e Shqipërisë u shoqëruan me mbylljen e disa bizneseve si hotele, bare, restorante, parukeri dhe sektorë shërbimesh të tjera. Gjithashtu, pezullimi i udhëtimeve pa leje, shtyrjet apo anulimi i fluturimeve për një periudhë të caktuar, ndikoi rëndë anën e kërkesës dhe ofertës së ekonomisë. Përveç gjunjëzimit të sektorëve ekonomikë, pandemia shtriu ndikimin e saj negativ edhe në sektorë të tjerë. Në këtë kuadër, mbyllja dhe zgjatja e masave kufizuese kërcënoi mbledhjen dhe menaxhimin e të dhënave nga institucionet statistikore dhe e vuri Institutin e Statistikave (INSTAT) përballë disa vështirësive. Nga ana tjetër, informacioni statistikor u bë më i rëndësishëm se kurrë për të kuptuar trendin dhe ndikimin e pandemisë. Gjithashtu, statistikatat e çertifikuara u bënë thelbësore për qeveritë për të hartuar dhe planifikuar strategjitë e reagimit (OECD, 2020).

Ndër sektorët e ndikuar për mbledhjen e të dhënave dhe informacionit, pandemia zgjeroi degët e saj deri në implikimin e përpilimit të Indeksit të Çmimeve të Konsumit (IÇK) dhe të përpilimit të Indeksit të Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit (IHÇK), (Link dhe Chessa, 2020). Të dy këto

tregues përdoren për të matur normën e inflacionit (INSTAT, 2020a; INSTAT, 2020b). Përpilimi i IÇK-së dhe IHÇK-së bëhet edhe më kuptimplotë sepse meqenëse IÇK mat ndryshimin e nivelit të përgjithshëm të çmimeve të mallrave dhe shërbimeve që familjet blejnë për konsum (FMN, 2020), në këtë mënyrë përcjell sinjale të qeveria në lidhje me sjelljen e konsumit dhe tendencat ekonomike gjatë periudhës së pandemisë. Ndërsa IHÇK përdoret si një matës agregat i inflacionit për zonën e euros dhe për të krahasuar normën e inflacionit në vendet anëtare të BE-së për qëllimet e politikave monetare dhe ekonomike (IMF, 2020), pra krahason normën e inflacionit të Shqipërisë me vendet e tjera të BE-së.

Për më tepër, gjatë mbylljes, mbledhja dhe përpunimi i çmimeve rezultoi gati i pamënaxhueshëm sepse mbledhja e drejtpërdrejtë e të dhënave nga INSTAT u bë i ndërlikuar për shkak të vështirësisë për të arritur tek ofruesit e të dhënave, apo sepse dyqanet ishin mbyllur ose funksiononin në kushte shumë kufizuese.

Pavarësisht nga implikimet e shfaqura, INSTAT duhet të masë dhe llogariste sa më saktë ndryshimin e çmimit para dhe pas periudhës së masave kufizuese. Për të mbushur këtë boshllëk dhe për të siguruar vazhdimësinë e përpilimit të IÇK-së dhe IHÇK-së, Eurostat dhe institucione të tjera propozuan udhëzime metodologjike se si të trajtohen pengesa të tilla. Për shembull, ju sugjerua shteteve anëtare që në rastet kur grumbullimi i çmimeve në terren është i pamundur të përdoret interneti dhe burimeve të tjera dytësore (p.sh. scanner data, marrja e informacionit me telefon) ose të merren në konsideratë teknikat e imputimit.

2. NDIKIMET E COVID-19 NË INSTITUTIN E STATISTIKAVE

Pas valës së parë të Covid-19, masat kufizuese u zbutën gradualisht, por megjithatë qeveritë nuk ishin në gjendje t'i kthenin vendet e tyre në aktivitet normal si në kohën para pandemisë dhe kjo u bë e dukshme në fund të vitit 2020 me ardhjen e valës së dytë të pandemisë dhe vazhdimësia e saj gjatë vitit 2021.

Ashtu si në sektorë të tjerë, INSTAT u përball me vështirësi të mëdha në prodhimin e IÇK-së dhe IHÇK-së. Banka Qendrore Evropiane (BQE) theksoi se midis ndikimeve të tjera, dy çështje kryesore ndikuan në përpilimin e IÇK-së dhe IHÇK-së. Së pari, pandemia ndikoi në masë të madhe tek shpenzimet e konsumatorëve, nga ku disa produkte nuk u pasqyruan në indekset e çmimeve të konsumit dhe së dyti, masat e mbylljes dhe masat kufizuese ndërlikuan në mbledhjen e çmimeve të produkteve, megjithëse të dhënat e munguara duhej të imputoheshin (Kouvavas et al., 2020).

INSTAT reagoi ndaj këtyre pengesave në të njëjtën masë si vendet e BE-së duke reaguar dhe përshtatur me shpejtësi mënyren e komunikimit me ofruesit e çmimeve. Gjithashtu, nëpërmjet burimeve të teknologjisë dhe telekomunikacionit u përpoq të shmangte në minimum mbledhjen e të dhënave me metodën tradicionale ballë për ballë. Në njërën anë metoda tradicionale ballë për ballë ishte e pamundur për shkak të respektimit të masave të distancimit social, dhe nga ana tjetër për shkak të masave kufizuese (mbylljes). Edhe pse pandemia pati ndikim të ndryshëm midis sektorëve, disa çmime produktesh u bënë më të vështira për t'u rikuperuar përmes metodave alternative (telefon dhe internet) dhe nevoja për metoda të tjera u bënë të nevojshme (teknikat e imputimit). Prandaj implikimet kryesore me të cilat u përball INSTAT në mbledhjen e çmimeve dhe përpilimin e IÇK-së dhe IHÇK-së ishin të tilla:

për shembull, disa aktivitete që nuk funksiononin gjatë mbylljes (p.sh. parukeritë, dentistët, restorantet, shërbimi i transportit), përveç kufizimeve të tjera, hasi kosto shtesë dhe tarifa të pa përjetuara më parë (p.sh. përdorimi i maskave, pajisjeve dezinfektuese ose kufizimi i numrit të disponueshëm të sediljeve për shërbimet e transportit). Duke ndikuar në rritjen e çmimit të shërbimit dhe përfundimisht në IÇK dhe IHÇK (Eurostat, 2020b).

Gjithashtu, konsumatorët i përshtatën zakonet e tyre të konsumit me rrethanat e reja (Eurostat 2020c). Nevojat e familjeve i shtynë të fusin në shportën e tyre të konsumit disa mallra të tjera dhe të heqin disa të tjera që ishin mësuar të konsumojnë. Ky ndryshim në sjelljen e tyre të konsumit ndryshoi përfundimisht agregatët elementar.

Një tjetër implikim lidhet me raportin e konsumatorëve për blerjen e produkteve ose shërbimeve. Masat e bllokimit dhe kufizimit të vendosura nga qeveritë për aktivitetet normale të jetës dhe lëvizjet e njerëzve ngritën situata të dyshimta dhe të pasigurta për shumë individë. Për shembull, konsumatorët shmangën prenotimin paraprak të biletave të fluturimit ose pushimeve. Gjithashtu aty ku ishte e mundur, punonjësit përshtatën kushtet e tyre të punës duke përdorur burimet teknologjike duke kryer detyrat e tyre të punës nga distanca dhe duke shmangur udhëtimet. Ndryshime të tilla të sjelljes ndikuan në cilësinë e shërbimit dhe ndikuan në çmimet e produkteve, duke çuar në nevojën për rregullim cilësor të çmimeve.

Kështu, një implikim tjetër lidhet me ndryshimin e cilësisë së produkteve dhe rregullimin e cilësisë. Çdo produkt i shitur përpara periudhës së bllokimit mund të shërbehet me cilësi të ndryshme pas mbylljes. Për shembull, në rastin kur shumica e shërbimeve ushqimore kthehen në produkte “merr me vete”, cilësia e produktit të shërbyer mund të jetë e ndryshme për çështje të ndryshme të cilat nuk janë të mundshme të përgjithësohen nëse nuk bëhen vëzhgime rast pas rasti. Prandaj, paaftësia për të vlerësuar ndryshimin e cilësisë çon në një paaftësi për të rregulluar çmimet në bazë të cilësisë. Gjithashtu, implikimet e Covid-19 ekspozuan çmime të tjera të produkteve që nuk përfshiheshin në llogaritjen e CPI-së në të kaluarën, si produkte që shërbyen për të parandaluar përhapjen e Covid-19 (p.sh. maska për fytyrën, pajisje dezinfektuese). Shfaqja e papritur e produkteve të tilla çoi në rishikimin e listës së agregatëve elementare sipas ECOICOP dhe peshave të shpenzimeve të cilat mbahen konstante dhe duhet të përditësohen në vitet e njëpasnjëshme (Eurostat, 2020b).

Pavarësisht fillimit të procesit të vaksinimit, aktivitetet ekonomike është vështirë të kthehen si në periudhën para pandemisë në një afat të shkurtër kohor. Këto efekte do të nxisnin institutin e statistikave për të vlerësuar peshat e IHÇK-në për vitin 2021 krahasuar me peshat e vitit 2020, si një mënyrë për të shmangur çdo vlerësim të njëanshëm të indekseve agregate të IHÇK-së (Eurostat 2020c).

3. METODAT E IMPUTIMIT NË PRODHIMIN E IÇK DHE IHÇK

Ndikimet e Covid-19 për mbledhjen e çmimeve detyroi INSTAT të miratojnë metodat alternative që përdorin për përpilimin e IÇK-së dhe IHÇK-së. Zyrtat statistikore u angazhuan për përpilimin dhe gjenerimin e IÇK-së dhe IHÇK-së në shumicën e vendeve. Në këtë kontekst në kohën e pandemisë, Eurostat ka sugjeruar dhe përditësuar vazhdimisht metodat e imputimit dhe teknikat e mbledhjes së çmimeve që institutet kombëtare të statistikave janë propozuar të marrin në konsideratë për të prodhuar të dhëna të shpejta dhe të vërtetuara në koherencë

me kërkesat. Për shembull, kur produkti është i disponueshëm në treg dhe i tregtueshëm, çmimi i imputuar nënkupton çmimin e mbledhur më parë për produktin me një ndryshim të përshtatshëm çmimi. Gjithashtu, për produktet e konsideruara si zëvendësues të përafërt mund të imputohet çmimi i produkteve të ngjashme në strukturën e klasifikimit të përdorur për IHÇK (d.m.th. ECOICOP) (Eurostat, 2020a). Një shembull udhëzuesi nga Eurostat, (2020a) tregon: supozoni se mungon një nga 3 nënklasat, imputimi i kësaj nënklase mund të bazohet në klasën të cilës i përket nënklasa (për sqarime të hollësishme referojuni Eurostat, 2020a). Në rastet kur nuk është e mundur të bëhet transaksioni i produkteve, Eurostat nënvizon dy metodologji alternative për rregullat e imputimit. Së pari, imputimi me të gjithë indekset e besueshme të çmimeve (d.m.th. imputim për më pak se 50% të peshave të tij); e dyta, metoda “carry forward”. Në rastin e parë, kur produkti është në treg dhe nuk mund të gjenerohet informacion i mirë dhe i saktë, sugjerohet që të merren parasysh të gjitha vlerësimet e besueshme të nën-indekseve. Në rastin e dytë, (carry forward), sygjerohet vazhdimi i imputimit me çmimet e fundit të vëzhguara. Përcaktimi i çmimit të imputuar, aty ku është e mundur, i referohet çmimeve të fundit të vëzhguara dhe është i përshtatshëm kryesisht për një produkt që pritet të mos ketë ndryshim çmimi ose edhe nëse ka ndodhur do të kthehet në të njëjtën tendencë me kalimin e kohës (Eurostat, 2020a). Për më tepër, disa produkte janë sezonale, kështu që çmimet e këtyre produkteve nuk kanë vazhdimësi, por ato ndikohen sezonalisht, si psh shërbimet e akomodimit ose paketat turistikë. Gjatë periudhave të krizës dhe bllokimit konstatohet një tranzicion i kufizuar i disa produkteve sezonale duke penguar vlerësimin e normës vjetore të ndryshimit për nëngrupet përkatëse. Në rrethana të tilla, sugjerohen dy metoda kryesore. Metoda e imputimit me normën vjetore të ndryshimit të të gjithë indekseve të besueshme të çmimeve dhe metoda “carry forward” me një faktor korrigjues sezonal. Në rastin e parë metoda e imputimit duhet të marrë në konsideratë të gjitha çmimet e besueshme të vitit të kaluar. Preferohet të përdoret kjo metodë duke aplikuar normë vjetore të ndryshimit të të gjithë indekseve të besueshme të çmimeve me çmimin e vërejtur një vit më parë. Ndërsa në rastin e dytë, çmimi i imputuar gjenerohet duke shumëzuar çmimet e muajit të mëparshëm me faktorët sezonalë. Një shpjegim më i drejtpërdrejtë dhe zbatimi praktik i këtyre metodave gjendet në Eurostat, (2020a).

4. PËRSHTATJA E INSTAT NË PRODHIMIN E IÇK-SË DHE IHÇK-SË NËN KËRCËNIMET E COVID-19

4.1. Përshtatjet metodologjike

Në përputhje me zhvillimet metodologjike nga Eurostat dhe Fondet Monetare Ndërkombëtare (FMN), INSTAT u gjend në kushtet që kërkonin përditësimin dhe përdorimin e metodave alternative për mbledhjen dhe imputimin e të dhënave për llogaritjen e IÇK-së dhe IHÇK-së gjatë pandemisë. Metodatat e mbledhjes së çmimeve dhe imputimit janë përditësuar në përputhje me statusin dhe disponueshmërinë e produkteve. Në rastin kur produktet janë në shitje dhe dyqanet janë të hapura, mbledhja e të dhënave kryhet nëpërmjet intervistimit direkt në dyqan. Në rast se mbledhja e të dhënave në dyqanet bëhet e pamundur, INSTAT përdorë alternativa të tjera për mbledhjen e të dhënave, si marrja e çmimeve nga interneti apo nga faqet zyrtare

të njësive tregtare. Kur është e pamundur të mblidhen të dhënat nga interneti, alternativë tjetër e përdorur është nëpërmjet telefonit si dhe nëpërmjet listës së çmimeve. Ndërsa, në rastet kur njësitë tregtare janë të mbyllura dhe produktet nuk janë në shitje atëherë ndiqen metoda alternative të imputimit bazuar në opsionin që pasqyron më së miri sjelljen e çmimit të produktit që mungon, për shembull, disa metoda të imputimit të ndjekura janë si më poshtë:

- kur mund të mblidhen çmime për një ose disa produkte brenda të njëjtit grup, çmimet e produkteve të tjera (d.m.th. kur çmimet e tyre nuk janë të disponueshme në muajin aktual) do të llogariten bazuar në diferencën mujore të produkteve të ngjashme.
- për produktet që janë të qëndrueshme me kalimin e kohës dhe nuk tregojnë diferenca të mëdha në çmime nga muaji në muaj është gjetur e përshtatshme të përdoret metoda e imputimit “carry forward”.
- në rastin kur çmimet e produkteve mungojnë për të gjithë grupin si p.sh. veshje dhe këpucë apo bare dhe restorante, çmimet imputohen duke marrë parasysh ndryshimin mujor të çmimit.
- çmimet e produkteve që kanë sezonalitet (biletat e avionit, pushimet, shërbimet e akomodimit, etj), imputohen me ndryshimin mujor të një viti më parë.

4.2. Implementimi në praktikë

Tabela 1 tregon metodat e përdorura për mbledhjen e çmimeve dhe metodat e imputimit për secilin grup për përpilimin e IÇK-së dhe IHÇK-së. Shenja x në tabelë tregon strategjinë përkatëse të ndjekur për mbledhjen ose imputimin e çmimeve. Nga vëzhgimi i parë i tabelës, mund të konkludohet se për disa grupe produktesh nuk ka nevojë të përdoret ndonjë metodë imputimi. Në këtë rast mbledhja e të dhënave është bërë në terren ose çmimet e produkteve mblidhen përmes internetit në faqet zyrtare të njësive tregtare me pakicë ose nëpërmjet telefonit. Në rastet ku ishte e pamundur të mblidheshin çmimet me tre mënyrat e mësipërme, INSTAT iu përshtat metodave të imputimit. Për më tepër, vlen të përmendet fakti se pandemia nuk e ndërpreu procesin e mbledhjes direkte të çmimeve për të gjithë elementët e secilit grup (që tregohet nga shenja x në secilin grup të metodës së mbledhjes së drejtpërdrejtë) dhe metodat e imputimit përdoren vetëm për disa grup produktesh të caktuara.

Tabla 1. Metodat e mbledhjes dhe imputimit të të dhënave sipas 12 grupeve kryesore

Grupi	Përshkrimi	Metodat e aplikuara		
		Direct collection	Reliable indices	“carry forward”
1	Ushqime dhe pije joalkolike	x		
2	Pije alkolike dhe duhan	x		
3	Veshje dhe kepucë	x	x	
4	Qera, ujë lëndë djegëse dhe energji	x		x
5	Mobilim, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	x	x	x
6	Shëndeti	x		
7	Transport	x	x	
8	Komunikimi	x		
9	Argëtim dhe kulturë	x	x	x
10	Shërbimi arsimor	x		x
11	Hotele, kafene dhe restorante	x	x	x
12	Mallra dhe shërbime të ndryshme	x	x	

Për të garantuar prodhimin e IÇK-së dhe IHÇK-së, INSTAT, krahas rekomandimeve të FMN-së dhe Eurostat-it, bazohet në Rregulloren e KE-së Nr. 2494/95, Ligjin Nr. 17/2018 mbi Statistikat Zyrtare dhe Programin Kombëtar të Statistikave Zyrtare 2017-2021. Në këtë kontekst, më poshtë jepet një përshkrim i metodave të ndjekura për përpilimin e IÇK-së dhe IHÇK-së për muajin Prill 2020 për 12 grupet kryesore:

1. Ushqime dhe pije joalkolike

Njësit tregtare që tregtonin produkte ushqimore dhe farmaceutike gjatë muajin Prill qëndronin të me orar të reduktuar (deri 17.30). Çmimet për këto produkte për të gjitha rrethet janë grumbulluar nëpërmjet intervistës direkte në njësitë tregtare.

2. *Pije alkolike dhe duhan*

U përdor e njëjta mënyrë si në grupin e parë.

3. *Veshje dhe keputë*

Njësit tregtare që tregonin veshje dhe këpucë kanë qenë të mbyllura gjatë muajit Prill, çmimet e këtij grupi janë imputuar. Imputimi është bërë bazuar me ndryshimin mujor të çmimeve të muajit Prill 2019. Gjithashtu, janë mbledhur edhe çmime online për disa njësi tregtare ku ka qenë e mundur, kryesisht në qytetin e Tiranës.

4. *Qera, ujë lëndë djegëse dhe energji*

Çmimet për disa produkte të këtij grupi janë çmime të administruara dhe nuk kanë ndryshuar, siç janë çmimi i ujit dhe energjisë elektrike. Ndërsa, për produktet e tjera që nuk kishin ndryshueshmëri të madhe nga një muaj në tjetrin çmimi është mbajtur i pa ndryshuar dhe është përdorur metoda e imputimit “carry forward”.

5. *Mobilim, pajisje shtepie dhe mirëmbajtje e shtëpisë*

Produktet e këtij grupi janë heterogjen dhe për grumbullimin e çmimeve janë përdorur disa metoda. Çmimet për disa produkte ku ka qenë e mundur janë mbledhur online duke përdorur website-et e njërive tregtare (për produkte si frigorifer, lavatrice e pajisje të tjera shtëpiake). Çmimet për produktet, si detergjent, solucion për larje enësh, xhamash e të tjera të ngjashme janë grumbulluar nëpërmjet intervistës direkte në supermarketet apo mini markete. Disa çmime janë imputuar duke përdorur metodën e imputimit me ndryshimin mujor të produkteve të ngjashme brenda grupit. Gjithashtu, është përdorur metoda “carry forward” për imputim të çmimeve për produktet që skanë shumë luhatje mujore të çmimeve si dhoma gjumi, perde, kolltuqe, kova plastike, qirinj, shkrepse, etj.

6. *Shëndeti*

Çmimet për këtë grup artikujsh janë mbledhur në njësitë tregtare nëpërmjet intervistës direkte dhe nuk ka qenë e nevojshme imputimi i çmimeve.

7. *Transporti*

Për këtë grup janë ndjekur dy metoda për përcaktimin e çmimeve. Së pari, aty ku ishte e mundur, çmimet u mblodhën përmes intervistës të drejtpërdrejtë si p.sh. çmimet e naftës, benzinës dhe gazit të lëngshëm për makina. Së dyti, aty ku intervistat direkte ishin të pamundura, u përdor metoda e imputimit duke marrë indeksin muaj pas muaji nga viti i mëparshëm për produktet sezonale. Ndonëse, çmimet e biletave të transportit ajror dhe biletat e transportit detar edhe pse çmimet ishin grumbulluar dy muaj përpara, çmimet u imputuan me ndryshimin mujor të muajit Prill 2019 për shkak të ndërprerjes së udhëtimeve për këtë muaj. Çmimet e makinave janë imputuar me ndryshimin mujor të vitit të mëparshëm, sipas rekomandimeve të Eurostat.

8. Komunikimi

Çmimet e këtij grupi janë mbledhur në internet duke përdorur faqet zyrtare të njësive tregtare. Në këtë grup bëjnë pjesë artikuj ku është e mundur përdorimi i kësaj metode për mbledhjen e çmimeve, si shërbime postare, shërbime të telefonive fikse e celulare, etj.

9. Argëtim dhe kulturë

Ashtu si në grupin 5, për shkak të heterogjenitetit të produkteve, u përdorën disa metoda për mbledhjen dhe trajtimin e çmimeve. Çmimet për disa produkte ku ka qenë e mundur si televizorë, kompjutera, DVD, etj, janë mbledhur online duke përdorur faqet zyrtare të njësive tregtare. Çmimet e produkteve si lule, ushqime për kafshë, artikuj kancelarie e të tjera të ngjashme janë grumbulluar nëpërmjet intervistës direkte në supermarkete dhe minimarkete. Disa çmime janë imputuar duke përdorur metodën e imputimit me ndryshimin mujor të produkteve të ngjashme brenda grupit. Gjithashtu është përdorur metoda e imputimit “carry forward” për produktet që skanë shumë luhatje mujore të çmimeve si biletat për kinema, aktivitete sportive, etj. Ndërsa, çmimet për paketat turistike brenda dhe jashtë vendit janë imputuar me ndryshimin mujor të muajit Prill 2019.

10. Shërbimi arsimor

Në këtë grup ka çmime që mblidhen një herë në vit si: tarifat e universiteteve dhe tarifat e shkollave të cikleve të tjera. Gjithashtu, është përdorur metoda “carry forward” për imputimin e çmimeve për produktet e tjera të këtij grupi, si psh. kurset e ndryshme.

11. Hotele, kafene dhe restorante

Çmimet e produkteve për këtë grup sipas rekomandimeve janë imputuar me ndryshimin mujor të muajit Prill 2019 dhe llogariten me indeksin mujor të vitit të kaluar (Prill 2019). Ndërsa, çmimet për kafenetë dhe restorantet janë mbajtur të pa ndryshuara.

12. Mallra dhe shërbime të ndryshme

Për këtë grup janë ndjekur dy metoda për përcaktimin e çmimeve. Intervista direkte për produkte të ndryshme të kujdesit personal si kolinoz, furçe dhëmbësh, fasoleta etj dhe imputim çmimesh për produkte të ngjashme.

4. PËRFUNDIME

Përhapja e Covid-19 e solli INSTAT-in përballë një situatë të paprecedentë duke kërcënuar praktikat e mbledhjes dhe përpilimit të të dhënave. Duke marrë parasysh edhe sektorë të tjerë, sektori i mbledhjes së të dhënave të çmimeve dhe përpilimit të IÇK-së dhe IHÇK-së ishte në rrezik dhe përshtatja e tij me metoda alternative u bë e pashmangshme. INSTAT për të kapërcyer këtë pengesë dhe për të vazhduar prodhimin e IÇK-së dhe IHÇK-së u bazuan në udhëzimet dhe rregulloret që Eurostat dhe FMN nxorren për situatën pandemike në lidhje me zhvillimin e metodave të mbledhjes së të dhënave dhe imputimit, ku rëndësia e secilës metodë ndryshonte me kategorinë e produktit dhe me disponueshmërinë e çmimeve për secilën kategori.

Në përputhje me sfidat e krizës, INSTAT u bë më vigjilent dhe i vendosur në zhvillimin e metodave të qëndrueshme dhe të besueshme për të luftuar ndikimin negativ të pandemisë në mbledhjen e të dhënave dhe metodave të imputimit për të prodhuar tregues të besueshëm dhe koherent të IÇK-së dhe IHÇK-së. Megjithatë, përshtatja e metodologjisë kërkohet të validohet dhe përditësohet me kalimin e kohës dhe të përshtatet me nevojat, sepse për një kohëzgjatje të gjatë të krizës këto metoda mund të jenë joefektive. Për shembull, kur merret në konsideratë çmimi i imputimit si zëvendësues i produktit të cilët janë të ngjashëm me njëri-tjetrin, duhet të merret parasysh se imputimi i çmimeve duhet të zgjidhet në mënyrë të arsyeshme dhe jo rastësore (sepse në të kundërt, çmimi i imputuar mund të mos pasqyrojë çmimin e vërtetë të indekseve që mungojnë). Për më tepër metoda e imputimit bazohet në indekse të besueshme, përveç kufizimit të tij në disponueshmërinë e kategorive të produktit, kur është e disponueshme konsiston në parimet që IÇK/IHÇK duhet të bazohet në çmimet e vrojtuar. Një implikim tjetër lidhet me metodën e “carry forward”. Me rritjen e numrit të çmimeve të imputuara me metodën “carry forward”, ndryshimi mujor i çmimeve konvergjon në zero (Eurostat, 2020a). Në këtë aspekt, INSTAT duhet të jetë vigjilent ndaj besueshmërisë dhe përshtatshmërisë së këtyre qasjeve metodologjike ndaj problemeve pandemike. Po kështu, kriza pandemike mund të konsiderohet si një shtysë për të përshtatur dhe zhvilluar metoda ose strategji të reja koherente dhe efektive me rëndësi të lartë për mbledhjen dhe imputimin e të dhënave, veçanërisht për çmimet. Prandaj, duke qenë se statistikë zyrtare janë burimi kryesor i informacionit, nevoja për qasje më të detajuara dhe gjithëpërfshirëse janë edhe më të rëndësishme për t’u përballur me kohëzgjatjen e gjatë të krizës dhe për tu përgatitur për krizat e ardhshme.

REFERENCA

1. Eurostat, 2020a. Methodological notes. Guidance on the compilation of the HICP in the context of the Covid-19 crisis. Eurostat, Directorate C. Unit C4 – Price statistics; purchasing power parities; housing statistics.
https://ec.europa.eu/eurostat/documents/10186/10693286/HICP_guidance.pdf
2. Eurostat, 2020b. Guidance note on HICP issues emerging from the lifting of lockdown measures. Eurostat, Directorate C. Unit C4 – Price statistics; purchasing power parities; housing statistics.
https://ec.europa.eu/eurostat/documents/10186/10693286/HICP_lifting_lockdown_measures_guidance.pdf
3. Eurostat, 2020c. Guidance on the compilation of HICP weights in case of large changes in consumer expenditures. Eurostat, Directorate C, Macro-Economic Statistics.
<https://ec.europa.eu/eurostat/documents/10186/10693286/Guidance-on-the-compilation-of-HICP-weights-in-case-of-large-changes-in-consumer-expenditures.pdf>
4. IMF 2020. Consumer price index manual. Concepts and methods. International Labour Organization/International Monetary Fund/Organisation for Economic Co-operation and Development/European Union/United Nations/The World Bank.
5. INSTAT. 2020a. Harmonised index of consumer prices.
http://www.instat.gov.al/media/7309/hicp_june_2020.pdf
6. INSTAT. 2020b. Harmonised index of consumer prices.
http://www.instat.gov.al/media/7340/cpi_julay_2020.pdf
7. Kouvavas, O. Trezzi, R. Eiglsperger, M. Goldhammer, B. and Gonçalves, B. 2020 Consumption patterns and inflation measurement issues during the COVID-19 pandemic. Published as part of the ECB Economic Bulletin, Issue 7.
8. Link and Chessa, 2020. Impact of imputation methods on the CIP and HICP in view of the COVID-19 crisis
9. MSHMS, 2020a. Informacion i përditësuar për Koronavirusin COVID_19. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
https://shendetesia.gov.al/9-mars-2020-informacion-i-perditesuar-per-koronavirusin-covid_19/

10. MSHMS, 2020b. Urdhër “Për një ndryshim në urdhrin nr.193, datë 20.03.2020 ” Për mbylljen apo kufizimin e lëvizjeve në Republikën e Shqipërisë”.
<https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2020/03/193-urdher-per-mbylljen-apo-kufizimin-e-levizjeve-ne-Republiken-e-Shqiperise.pdf>

ANALIZA E MANGËSIVE LIGJORE ME RREGULLORET E BE–KAPITULLI 18

Estela Karaj¹

Abstrakt

Një nga shtyllat kryesore në planin e hapave kyç në përgatitjen e takimeve bilaterale është përgatitja e vlerësimit të mangësive ligjore LGA (legal assessment gap analysis).

LGA është një mjet i domosdoshëm në procesin e integritit për identifikimin sistematik të aktiviteteve të kërkuara legjislativë për tu harmonizuar më tej me *acquis*-in e BE-së. Për këtë arsye, ajo ofron bazën për planifikimin e iniciativave legjislativë të synuara dhe azhurnimet e rregullta të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE). Në të njëjtën kohë, ajo përgatit terrenin për shqyrtimin dhe zhvillimin e pozicioneve negociuese në negociatat e integritit.

Synimi i këtij artikulli është ofrimi i një informacioni sqarues mbi statusin e përgatitjes së LGA-së për kapitullin 18 “Statistikat” dhe planin e INSTAT-it për përafrimin me *acquis*. Ky informacioni bazohet në aktivitetin e deritanishëm të INSTAT si institucioni lider për këtë kapitull.



Fjalë kyçe:

Analiza e mangësive ligjore, Kapitulli 18, *Acquis communautaire*

1. Instituti i Statistikave, ekaraj@instat.gov.al

1. HYRJJE

Acquis communautaire e quajtur nganjëherë acquis e BE dhe shpesh e shkurtuar në acquis, është legjislacioni i akumuluar, aktet ligjore dhe vendimet gjyqësore që përbëjnë trupin e ligjit të Bashkimit Evropian.

Gjatë procesit të zgjerimit të Bashkimit Evropian, acquis u nda në 31 kapituj për qëllimin e negociatave midis BE dhe vendeve anëtare candidate për zgjerimin e pestë. Më tej, për negociatat me Kroacinë (e cila u anëtarësua në 2013), Islandën, Turqinë, Malin e Zi, Serbinë dhe në të ardhmen, me Maqedoninë e Veriut, Shqipërinë (vendet candidate), acquis është ndarë në 35 kapituj, me qëllim balancimin më të mirë midis kapitujve.

Ndër 35 kapituj me të cilat Shqipëria duhet të përafrojë legjislacionin është dhe kapitulli 18-Statistikat. Instituti i Statistikave është institucioni lider për këtë kapitull.

Detyrimi për të përafuar legjislacionin shqiptar për statistikat zyrtare me atë të Bashkimit Evropian buron nga nenet 70 dhe 88 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA). Neni 88 parashikon se “bashkëpunimi midis palëve do të përqëndrohet kryesisht në fushat prioritare që lidhen me acquis communautaire në fushën e statistikave”. Kjo do të synojë në veçanti zhvillimin e një sistemi statistikor efikas dhe të qëndrueshëm, të aftë për të siguruar të dhëna të krahasueshme, të besueshme, objektive dhe të sakta, të nevojshme për të planifikuar dhe monitoruar procesin e tranzicionit dhe reformat në Shqipëri.

Ai gjithashtu do t’i mundësojë Institutit të Statistikave që të plotësojë më mirë nevojat e përdoruesve të saj kombëtarë dhe ndërkombëtarë (si administratës publike, ashtu edhe sektorit privat). Sistemi statistikor duhet të respektojë parimet themelore të statistikave të miratuara nga Kombet e Bashkuara, Kodin e Praktikave të Statistikave Evropiane dhe dispozitat e Ligjit Evropian Statistikor.

Acquis në fushën e statistikave përbëhet pothuajse ekskluzivisht nga legjislacioni, i cili është direkt i zbatueshëm në Shtetet anëtare siç janë Rregulloret e Parlamentit dhe të Këshillit Evropian dhe Vendimet dhe Rregulloret e Komisionit Evropian. Për metodologjinë, prodhimin dhe shpërndarjen e informacionit statistikor parashikohen rregulla të zakonshme. Acquis statistikore përmban gjithashtu një gamë të gjerë të manualeve metodologjike në fusha të ndryshme statistikore si bujqësia, politikat ekonomike dhe monetare, statistikat demografike dhe sociale dhe kërkimet.

Kapitulli 18-Statistikat është i ndarë në 5 fusha kryesore:

- Sistemi Kombëtar Statistikor;
- Statistikat Demografike dhe Sociale;
- Statistika Ekonomike;
- Statistikat Sektoriale;
- Statistikat e Mjedisit dhe Multidomain.

Instituti i Statistikave vepron si pikë referimi për metodologjinë, prodhimin dhe shpërndarjen e informacionit statistikor. Acquis mbulon metodologjinë, klasifikimet dhe procedurat për mbledhjen e të dhënave në fusha të ndryshme si statistikat makro-ekonomike, statistikat demografike dhe sociale, statistikat rajonale dhe statistikat mbi biznesin, transportin, tregtinë e jashtme, bujqësinë, mjedisin, shkencën dhe teknologjinë.

Në bashkëpunim me Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ), INSTAT ka realizuar plotësimin e tabelës së mangësive institucionale dhe administrative (IAGA- Institutional and Administrative Gap Assessment) dhe po punon për finalizimin e tabelës së mangësive ligjore (LGA- Legal Gap Analysis).

LGA është një mjet i domosdoshëm në procesin e integritit për identifikimin sistematik të aktiviteteve të kërkuara legjislative për tu harmonizuar më tej me acquis-të e BE-së. Për këtë arsye, ajo ofron bazën për planifikimin e iniciativave legjislative të synuara dhe përditësimet e rregullta të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE). Në të njëjtën kohë, ajo përgatit terrenin për shqyrtimin dhe zhvillimin e pozicioneve negociuese në negociatat e integritit. Analizat e boshllëqeve legjislative janë mjeti për këtë qëllim për të gjithë aktorët e përfshirë në procesin e përafrimit legjislativ.

PKIE 2021 - 2023, shërben si një instrument për planifikimin dhe monitorimin e detyrimeve që dalin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA) i cili synon priorizimin, planifikimin, monitorimin dhe vlerësimin e përafrimit të plotë të legjislacionit shqiptar me acquis të Bashkimit Evropian si një nga kriteret për anëtarësimin në Bashkimin Evropian.

Plani Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE) 2021–2023 përfshin masa ligjore dhe zbatuese afatshkurtra dhe afatmesme që shtrihen deri në vitin 2023, duke synuar përafrimin gradual të legjislacionit shqiptar me acquis e Bashkimit Evropian

Aktet e parashikuara të INSTAT të përfshira në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2021-2023 të miratuar me vendimin nr. 90, datë 17.2.2021 të Këshillit të Ministrave janë:

Tabela 1: PKIE - MASAT LIGJORE TË PLANIFIKUARA PËR PERIUdhËN 2021–2023

Kapitulli	NËnkapitulli	Acquis e BE-së	Legjislatiioni shqiptar	Lloji i aktit të përafuar	Dokument strategjik Po/Jo	Institucioni propozues	Niveli i synuar i përafritimit	Viti i përafritimit	Tremujori I planifikuar për miratim
18 STATISTIKAT									
18	Statistikat sektoriale	Regulation (EU) 2018/1091 of the European Parliament and of the Council of 18 July 2018 on integrated farm statistics and repealing Regulations (EC) No 1166/2008 and (EU) No 1337/2011	Projektligji “Për Censin e bujqësisë dhe fermave bujqësore 2022”.	Ligj	Jo	INSTAT	I plote	2022	IV
18	Statistikat sektoriale	Commission Regulation (EU) No 1106/2012 of 27 November 2012 implementing Regulation (EC) No 471/2009 of the European Parliament and of the Council on Community statistics relating to external trade with non-member countries.	Projektvendi m “Për zbatimin e Nomenklaturës së shteteve dhe territoreve në tregtinë e jashtme”.	VKM	Jo	INSTAT	I plote	2021	II
18	Statistikat sektoriale	32013R0549 - European System of Accounts 2010 (Reg No 549/2013).	Projektligj “Për zbatimin e standardeve evropiane të Sistemit të Llogarive Kombëtare”.	Ligj	Jo	Instat	I pjesshem	2023	IV

Aktet tashmë të miratuara në kuadër të procesit të përafritimit të legjislatiionit janë aktet si më poshtë:

- 1. Ligji nr. 17/2018 “Për Statistikat Zyrtare”
- 2. Ligji nr. 140/2020 datë 26.11.2020 “Për censin e popullsisë dhe të banesave”

Ndërkohë ka filluar puna për përgatitjen e PKIE 2022-2024 (periudha e planifikimit 1 janar 2022-31 dhjetor 2024).

2. PËRFUNDIME

Përafrimi i plotë i legjislacionit shqiptar me legjislacionin e Bashkimit Evropian, dhe zbatimi i plotë dhe efektiv i tij, janë një nga kriteret e Kopenhagenit për anëtarësimin në Bashkimin Evropian. Procesi i negociatave të anëtarësimit është në vetvete procesi i përafrimit të legjislacionit shqiptar me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

REFERENCA

Marrëveshja e stabilizim asociimit (MSA)

<http://integrimi-ne-be.punetejashtme.gov.al/ëp-content/uploads/2020/04/MSA-BE-Shqiperi-sq.pdf>

Vendimi Nr. 90, datë 17.2.2021 "Për miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2021 – 2023

<https://qbz.gov.al/eli/vendim/2021/02/17/90/b8a74244-4688-4227-bfb6-f75c873a5708;q=plani%20kombetar%20per%20integrimin%20evropian%202021>

NON-RESPONSE TREATMENT IN HOUSEHOLD SURVEYS IN BOSNIA AND HERZEGOVINA

(TRAJTIMI I MOSPËRGJIGJEVE NË ANKETAT PRANË FAMILJEVE NË BOSNJE DHE HERCEGOVINË)

Dajana Mrgud¹
Jasna Isaković²

Abstrakt

Anketat statistikore nuk janë aktivitete pa gabime, pavarësisht nëse ato kryhen në një mbulim të plotë apo në një kampion. Anketat pranë familjeve janë të bazuara në kampione janë një burim i arritshëm i të dhënave për prodhimin e treguesve të ndryshëm socialë dhe hartimin e politikave sociale në çdo vend. Këto anketa janë të ekspozuara ndaj gabimeve gjatë kampionit edhe dhe jo. Ndërsa gabimet e marrjes së kampionit mund të kontrollohen nga modeli i kampionimit, gabimet e ardhura nga proceset e tjera janë të vështira për t'u zbuluar. Një nga gabimet më të zakonshme të kampionimit janë gabimet e mospërgjigjes, të cilat u krijojnë shumë probleme menaxherëve të anketave. Agjencia për Statistikat e Bosnjës dhe Hercegovinës kryen anketa të ndryshme pranë familjeve, të gjitha në baza vullnetare dhe pa asnjë nxitje për të anketuarit. Ka pasur një rritje të përqindjeve të mospërgjigjeve në këto vrojtime dhe po bëhen përpjekje për t'i reduktuar ato si dhe për ndikimin e tyre negativ në vlerësimet e anketës. Qëllimi i këtij punimi është të paraqesë metoda të ndryshme për trajtimin e mospërgjigjeve në anketat pranë familjeve në Bosnje dhe Hercegovinë në mënyrë që të shmanget ose zvogëlohet potenciali për paragjykimin e mospërgjigjes. Punimi eksploron anketat më të rëndësishme pranë familjeve nga pikëpamja e mospërgjigjeve dhe paraqet metodat e përdorura për trajtimin e mospërgjigjeve të njësive dhe variabla në mënyrë që të merret grupi i plotë i të dhënave për analizën. Për më tepër, do të prezantohet ndikimi i pandemisë Covid-19 në anketat e fundit pranë familjeve dhe shkalla e mospërgjigjes së tyre. Pandemia shkaktoi pezullim të përkohshëm ose ndërprerje totale të disa anketave të familjeve, por motivi Agjencinë e Statistikave që të prezantojë një mënyrë alternative të mbledhjes së të dhënave, për të parandaluar humbjen e të dhënave dhe rritjen e normave të mospërgjigjeve. Të dhënat e përdorura në këtë studim ofrohen nga Agjencia për Statistikat e Bosnje dhe Hercegovinës dhe vijnë nga anketat e forcës së punës, anketat e buxhetit të familjeve, anketat e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit dhe anketat e tjera të familjeve të kryera më rrallë në Bosnje dhe Hercegovinë. Studimi tregon se mospërgjigjet e njësive zgjidhen duke peshuar dhe ajustuar pas anketës, ndërkohë që nuk ka asnjë metodë të standardizuar për trajtimin e mospërgjigjeve të variabla. Jepet një rishikim kritik i përdorimit të vetëm metodave klasike të imputimit të variabla. Punimi përfundon me propozimet për përdorimin e metodave të avancuara të imputimit të variabla, për standardizimin e metodave të imputimit brenda sistemit statistikor të Bosnjë-Hercegovinës dhe për përdorimin e teknikave moderne të mbledhjes së të dhënave dhe burimeve të reja të të dhënave (mikse, CATI, përdorimi i burimeve administrative, etj.).



Key words:

Household Survey, Non-Response Error,
Non-Response Rate, Data Quality

JEL classification: C180

1. Agjencia për Statistikat e Bosnjës dhe Hercegovinës,
dajana.mrgud@bhas.gov.ba

2. Agjencia për Statistikat e Bosnjës dhe Hercegovinës,
jasna.isakovic@bhas.gov.ba

Abstract

Statistical surveys are not error-free activities regardless of whether they are conducted on a full coverage or a sample. Sample based household surveys are a reach source of data for the production of various social indicators and design of social policies in every country. These surveys are exposed to sampling and non-sampling errors. While sampling errors can be controlled by sampling design, non-sampling errors are hard to be detected. One of the most common non-sampling errors are non-response errors, which make a lot of problems to survey managers.

The Agency for Statistics of Bosnia and Herzegovina conducts various household surveys, all on a voluntary basis and without any incentives for respondents. There has been an increase in non-response rates in these surveys and efforts are being made to reduce them as well as their negative impact on survey estimates.

The aim of this paper is to present different methods for dealing with non-response in the household surveys in Bosnia and Herzegovina in order to avoid or reduce the potential for the non-response bias. The paper explores most important household surveys from the point of view of non-responses and presents methods used for treatment of unit and item non-response in order to get the complete data set for the analysis.

In addition, the impact of the Covid-19 pandemic on recent household surveys and their non-response rates will be presented. The pandemic caused temporary suspension or total interruption of some household surveys, but it motivated the Agency for Statistics to introduce an alternative mode of data collection, in order to prevent data loss and the increase of the non-response rates.

The data used in this study are provided by the Agency for Statistics of Bosnia and Herzegovina and come from labor force surveys, household budget surveys, information and communication technology surveys and other household surveys conducted less frequently in Bosnia and Herzegovina.

The study shows that unit non-responses are solved by weighting and post-survey adjustments, while there is no standardized method(s) for dealing with item non-responses. A critical review of the use of only classical item imputation methods is given. The paper ends with the proposals for the use of advanced methods of item imputation, for the standardization of imputation methods within the statistical system of Bosnia and Herzegovina and for the use of modern data collection techniques and new data sources (mixed-mode, CATI, use of administrative sources, etc.).

Dajana Mrgud¹
Agjencia për Statistikat e Bosnjës dhe Hercegovinës ,
dajana.mrgud@bhas.gov.ba

Jasna Isaković
Agjencia për Statistikat e Bosnjës dhe Hercegovinës,
jasna.isakovic@bhas.gov.ba



Key words:

Household Survey, Non-Response Error,
Non-Response Rate, Data Quality

JEL classification: C180



1. INTRODUCTION

Depending on the coverage of the target population in data collection, statistical surveys can be conducted as sample surveys or as censuses. While censuses consider the total coverage of the target population, sample based surveys collect data from the part of the target population, called the sample. Budget limitations and high sample survey accuracy, which is a result of powerful statistical techniques and computer development, are most common reasons in favour of using sample surveys for official statistics production.

However, every statistical survey is a subject of errors, no matter is it based on total coverage or sample of statistical units. There are two main types of errors in statistical surveys:

- a) sampling errors and
- b) non-sampling errors.

Sampling errors are caused by the fact that only a part of the target population is used for data collection instead of the whole population. The sampling error can be defined as any difference between the sample values and the population values that may result from a limited sampling size. Sampling errors are measurable and their prevalence can be predefined and controlled by sample design.

